



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 01 / 2798 Dt. 11 / 12 / 2023

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2., të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e VI të mbajtur më datë 01.12.2023, mori këtë:

VENDIM

Prof. Ass. Dr. Mensur Neziri rizgjidhet në thirrjen akademike **Profesor Asistent** për lëndët nga fusha pedagogjike në Fakultetin e Edukimit në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Rizgjedhja është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 168, 169 dhe 172 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/742 të datës 28.04.2022.

I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statutit të Universitetit.

Emërimi zgjatë 4/katër/vite.

Të përmendurit i takon paga në pajtim me Ligjin për pagat në sektorin publik Ligji Nr. 08/L-196 të datës 05.01.2023.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

Arsyetim

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan ka shpallur konkurs Ref.nr.01/1637 të dt.13.09.2023, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik një mësimsdhënës në Fakultetin e Edukimit për lëndët: (Pedagogjia e edukimit parashkollor (2); Praktika pedagogjike II (2); Strategjitë e edukimit parashkollor (2); Komunikimi në edukim (2) në programet Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor; Kurrikula shkollore (3); Mësimi i bazuar në projekte (3) në programin master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor).


Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Prof. Ass. Dr. Mensur Neziri, i plotëson kushtet për t'u rizgjedh në thirrjen akademike Profesor Asistent për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve sipas raportit Ref.nr. 05/2593 të datës 30.11.2023, vendosi që Prof. Ass. Dr. Mensur Neziri të rizgjidhet në thirrjen akademike Profesor Asistent.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashitësa të Senatit të Universitetit.




Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku, Rektor
Kryesues i Senatit

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave